



Pranimi / Dorezimi Prilazje / Prilazje Received / Delivered		06-05-2022	2	viti god year
Organ / Shkëmbim Organ / Jedinstvo Org / Unit	Id / Prot Id / Prot Prot No	Shtesa Prilazje Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHEK	2659/2022		1/5	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.220/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.220/2022 të datës 10.03.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes avokatit \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Brendshme- Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.05.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 18.01.2021 me numër protokollit 131 të parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të kujdeset që zbatimimi i vendimit të bëhet konform pikës I të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 19.03.2022 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1285/2022 të regjistruar me numër A.nr.220/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

përgjigjeve, sqarimeve të datave 25.02.2022 dhe 08.03.2022 të lëshuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.03.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 29.03.2022 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/11.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes, me Vendimin VK.nr.28/2022 të datës 22.04.2022 të Kryetarit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës A.nr.220/2020 të datës 10.03.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova:** Ankesën me numër A.nr.220/2022 me numër të protokollit 1085/2022 të parashtruar nga ankuesi përmes avokatit me datën 10.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 26.11.2021; Vendimi A.nr.976/2021 i datës 10.01.2022 me numër protokollit 44/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 18.01.2022 me nr.131 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Sqarim i datës 25.02.2022 nga DMZP; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022; E-mail zyrtar i datës 08.03.2022; E-mail zyrtar i datës 26.02.2022; E-maili zyrtar i datës 21/04/2022, drejtuar këshillit; E-maili zyrtar i datës 23/12/2021, drejtuar udhëheqëses së personelit të institucionit-MINT nga drejtori i DMZP-së; E-maili zyrtar i datës 22/12/2021, drejtuar zyrtarëve të DMZP-së nga udhëheqësja e personelit të institucionit-MINT; E-maili zyrtar i datës 17/12/2021, drejtuar zyrtarëve të DMZP-së nga udhëheqësja e personelit të institucionit-MINT; E-maili zyrtar/kërkesë për sqarim i datës 16/12/2021, drejtuar zyrtarëve të DMZP-së nga udhëheqësja e personelit të institucionit-MINT, E-maili zyrtar/kërkesë për informatë e datës 16/12/2021, drejtuar udhëheqëses së personelit të institucionit-MINT nga zyra ligjore e kryeministrit; E-maili zyrtar/kërkesë për informatë e datës 16/12/2021, drejtuar zyrës ligjore të kryeministrit nga udhëheqësja e personelit të institucionit-MINT dhe Vendimi i datës 22.04.2022 me nr.VK.28/2022 për vazhdimin e afatit për vendimmarrje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të **detyrohet organi administrativ kompetent gjegjësisht drejtori i departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik**, që të nxjerrë akt administrativ, lidhur me kërkesën e datës 18.01.2022, të parashtruar nga ankuesi **SEPSE**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Ankuesi i emëruar në pozitë Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes përfaqësuesit të tij, fizikisht më datë 01.12.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Port:5733/2021, kundër Vendimit me Nr.31/45 të datës 24.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me pretendimet ankimore që vendimi është nxjerr me shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.01.2022 ka nxjerr Vendimi A.nr.976/2021 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, lidhur me emërimin e tij në pozitën Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut për mandatin e tretë.

Ankuesi, me datën 18.01.2022 ka parashtruar kërkesë për Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve përmes avokatit që të sistemoj ankuesin në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues, ashtu siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes shkresës së datës 25.02.2022 e ka njoftuar avokatin e ankuesit përmes sqarimit, me që rast është thirrur në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës duke specifikue nenin 13 të ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ligj me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-048 është shfuqizuar ligji Nr.03/L-192, që nënkupton se DMZP-ja gabimisht me rastin e këtij sqarimi i është referuar një ligji që nuk është në fuqi, mirëpo sipas shkresave të lëndës Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka theksuar që nuk ka kompetencë ligjore të veproj ndryshe nga vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.976/2021, në asnjë formë dhe në asnjë paragraf nuk ka përmendur faktin që ankuesit i mohohet e drejta për t'u sistemuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përkundrazi është konstatuar që përkundër që është shfuqizuar vendimi për vazhdimin e mandatit të tretë, nuk i është cenuar marrëdhënia e punës ankuesit (shih faqen 4, pjesën e fundit të paragrafit të dytë të vendimit të këshillit A.nr.976/2021), që nënkupton se me qenë se nuk i është cenuar marrëdhënia e punës me shfuqizimin e vendimit për vazhdimin e mandatit të tretë, konformë Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është obligim sistemimi nga DMZP-ja duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 i këtij Ligji.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese duke u bazuar edhe në pretendimin e ankuesit konstaton se ndërlidhja e aktit të shfuqizuar Nr.07/67, datë 26/02/2021 me dispozitat e Ligjit Nr.05./L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 53 paragrafi 2 është i domosdoshëm me rastin e trajtimit të kërkesës nga DMZP-ja, nga se shfuqizimi konformë kësaj dispozite të këtij ligji prodhon pasoja juridike për të ardhmen e jo në mënyrë retroaktive, andaj mbi këtë bazë me qenë se në këtë periudhë të shfuqizimit të këtij vendimi ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, atëherë DMZP-ja me rastin e trajtimit të kërkesës së datës 18.01.2022, domosdoshmërishtë duhet të ketë parasysh dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik.

Bazuar në të gjitha rrethanat që lidhen me ankuesin, mandati i dytë i ankuesit si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut ka përfunduar më datë 23.03.2021, çka nënkupton se mandati i ka skaduar në kohën kur ka qenë i zbatueshëm Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si institucion kompetent, njësi përgjegjëse

për institucionet e administratës shtetërore, është kompetente që për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese të cilëve i'u përfundon mandati, fillimisht të bëjë sistemimin e tyre në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka pozitë të tillë ndërsa nëse nuk ka ndonjë pozitë të këtij niveli brenda institucioneve që është përgjegjëse kjo njësi atëherë duhet ta sistemoj në pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale". Në këtë rast meqë ankuesit i ka përfunduar mandati i dytë më datë 22/03/2021 ashtu si ka qenë i specifikuar përmes vendimit Nr.04/37 të datës 23/03/2018 dhe pasi këshilli përmes vendimit A.nr.976/2021 ka konstatuar se vazhdimi i mandatit të tretë nuk ka qenë në harmoni me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit nuk i ka humbur e drejta për sistemim konformë legjislacionit të shërbimit civil që është në fuqi për arsye që mandati i tretë nuk ka ardhur si rezultat i kërkesave të ankuesit por i njëjti ka ardhur si rezultat i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës si institucion shtetëror kompetentë , dhe pasi vazhdimi i mandatit të tretë përmes vendimit Nr.07/67,të datës 26/02/2021 është konstatuar se ka qenë i kundërligjshëm, atëherë duhet pasur parasysh faktin që me përfundimin e mandatit të dytë kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë aplikohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të këtij ligji, i cili përcakton se: "7.Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale" dhe "8 Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 muajore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia epranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil", dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: "1.Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale".

Bazuar në të lartcekurat, obligohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, që në kuadër të kompetencave të tij, të rishqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 18.01.2022 dhe të nxjerr vendim meritore në harmoni me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që parasheh nxjerrjen e një akti administrativë, si dhe duke marrë parasysh edhe udhëzimet që janë potencuar në arsyetim të këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.220/2022, datë 06.05.2022

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- ❖ Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- ❖ Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

